



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:065183

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511724

P.nr.122/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.H (ndaj të cilit ishte veçuar procedura penale) nga ..., Komuna e Drenasit, të cilin sipas autorizimit e mbronë Avokat Shefqet Ibrahimimi nga Skenderaji, për vepër penale Rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.3630/19, dt.20.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 27.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ali Ajdini, mbrojtësit të akuzuarit Avokat Shefqet Ibrahimimi dhe të akuzuarit K.H, e në mungesën e palës së dëmtuar, me datë **27.03.2024** mori dhe shpalli, si dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

NDAJ TË AKUZUARIT: K.H, i biri i ... dhe e ..., e gjinisë ..., i lindur me datë.... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe e ka vendbanimin, me numër personal të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Në bazë të nenit 362 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

SE: me datë 14.07.2019, rreth orës 18:05, në rrugën Drenas-Komoran, konkretisht përball lulishtes “Tina” në Komoran, Komuna e Drenasit, i akuzuari B.H duke e drejtuar automjetin e udhëtarve të markës “VW” të tipit “Polo”, viti i prodhimit 2002, me targa të regjistrimit ..., me ngjyrë të kuqe, pronë e B.H nga ..., Komuna e Drenasit, kishte shkëlur ligjin mbi trafikun publik, kishte vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe nuk kishte pasur kujdes të shtuar për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, duke kontribuar me lëshimet sekondare në aksident, në atë mënyrë që, nga pakujdesia, dhe në kundërshtim me nenin 53.1. të LRRTRR-or, me të arritur përball lulishtes “Tina”, kishte lëvizur me shpejtësi më të madhe, se sa që është e lejuar, në atë pjesë të rrugës, kështu që kur i akuzuari K.H, kontribuesi primar i aksidentit, duke drejtuar

automjetin e udhëtarve të tij të markës “Damiler”, të tipit “Benz 201”, viti i prodhimit 1989, me targa të regjistrimit, me ngjyrë të kaftë, me të arritur përball kalim me automjetin e të akuzuarit B.H, dyshohet se merr veprim tejkalimi të biçiklistit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 73 par.2. nënpar.2.1. dhe 22 të LRRTRR-or, duke e zënë shiritin e drejtimit të lëvizjes së automjeti të akuzuarit B.H, ndërsa i akuzuari B.H instinktivisht del në shiritin e drejtimit të kundërt për të shmangur aksidentin me automjetin e të pandehurit K.H, i cili tenton të kthehet në momentet e fundit në shiritin e drejtimit të tij të lëvizjes, ku me të u kthyer me gjysmën e automjetit në shiritin e tij të lëvizjes goditet me pjesën e parë ballore, në pjesën e parë ballore të automjetit të akuzuarit B.H, me ç rast përveç dëmeve materiale, të akuzuarit kishin pësuar dëmtime të rënda trupore, -
-me këtë kishte për të kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Pasi që Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm Ali Ajdini në fillim të shqyrtimi gjyqësor është tërhequr nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore.

I dëmtuari B.H nga ..., Komuna e Drenasit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprën penale, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.3630/19, dt.20.04.2021, ka akuzuar të akuzuarin për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 370 par.8. lidhur me par.6. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.27.03.2024, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Ali Ajdini, mbrojtësi i të akuzuarit Avokat Shefqet Ibrahimimi dhe i akuzuari K.H, e në mungesën e palës së dëmtuar.

Prokurori i shtetit Ali Ajdini, në fillim të shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se: duke pasur parasysh superekspertizën e punuar nga ekspertët e komunikacionit Mr.sc.Halim Peci, Prof.Dr.Naser Lajqi dhe Msc.Egzon Qorraj, të cilët në konstatimin e mendimit përfundimtar kanë saktësuar se, shkaktar i aksidentit është i akuzuari B.H, i cili ka drejtuar veturën “VË Polo”, e jo i akuzuari K.H, për të cilin në ekspertizë thuhet, se ngasësi i veturës “Mercedes”, pra i akuzuari në fjalë, nuk ka bërë asnjë lëshim teknik, të cilat do të shkaktinin ndeshjen e komunikacionit. Prandaj, nuk mbetet tjetër, vetëm të konstatoj se në mungesë të provave, heqi dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit K.H.

Pasi që prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor hoqi dorë nga ndjekja penale, ndaj të akuzuarit, për veprën penale që akuzohet, gjykata ka konstatuar se lidhur me këtë çështje më tutje nuk ka çka të procedoi.

Nga këto arsye në bazë të nenit 362 par.1. nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, në fillim të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga aktakuza, gjykata ka marrë aktgjykim me të cilin ka refuzuar aktakuzën ndaj të akuzuarit K.H.

Vendimin që shpenzimet procedurale të paguhen nga mjetet buxhetore, gjykata e bazoi në nenin 453 par.1. të KPP-së.

Vendimin që në këtë rast i dëmtuari B.H nga ..., Komuna e Drenasit, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprën penale, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 462 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht të kësaj kërkesë.

Nga e lartetheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.122/2021, datë:27.03.2024

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

Gj y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).